STORIE
SUKSESI,
PROFILET
E GRAVE
NGA RAJONI
I DUKAGJINIT

MIMOZA KUSARI LILA

Kryetare e Gjakovës, ish Zëvendëskryeministre, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë dhe Zëvendës-Presidente e Aleancës Kosova e Re. Themeluese e Universitetit të parë Amerikan në Kosovë dhe ish Udhëheqëse e Odës Ekonomike Amerikane. Znj. Kusari është një grua e fuqishme. Pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare në vitin 2010, femra e parë me më së shumti vota në atë kohë. E magjistruar për Administrim Biznesi në Georgetown University në USA. Ajo ka inicuar projekte për përmisimin e biznesit në Kosovë, përsimin e indeksit të Bankës Botërore, Negocimin e politikave tregtare, Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit e shumë projekte tjera të suksesshme. Maratoniste e zonja, fituese e shumë cmimeve. Hobi i saj është vrapi të cilin e bën cdo mëngjes. Porosia e saj është të largojmë vetëfrikën dhe ti hapim rrugë të reja secila vetes.

Kryetarja e tanishme e Komunës së Gjakovës ka filluar punën në organizata vendore dhe ndërkombëtare menjëherë pas mbarimit të magistraturës në vitin 2001 ku magistroj për Administrim Biznesi në Georgetown University në SHBA. Ballafaqimi i saj me jetën politike ka qenë për herë të parë kur është ftuar aso kohe të angazhohet si zëdhënëse e kryeministrit të parë të zgjedhur në Qeverinë e Kosovës z. Bajram Rexhepi. Pas largimit nga kryeministria ajo është angazhuar si udhëheqëse e Odës Ekonomike Amerikane.

Në vitin 2010 ka qenë pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare ku edhe është zgjedhur si deputete e parlamentit të Kosovës me vota të sajë, e jo me kuotë zgjedhore duke qenë femra me më së shumti vota në Kosovë. Mimoza ka arritur të thej shumë strerotipe në Kosovë, duke qenë Zëvendëskryeministe dhe Ministre e Tregtisë dhe Industrisë ku ka inicuar projekte për përmirësimin e biznesit në Kosovë, ka negociuar politika tregtare përfshi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE –në si dhe shumë projekte tjera me rëndesi.

Në shpalljen e zgjedhjeve të reja lokale në vitin 2013 ajo kandidoi dhe fitoi garën për Kryetare të Komunës së Gjakovës. Udhëheqë gati për tre vite Komunën si e vetmja kryetare femër në Kosovë. Ajo shpreson shumë që zgjedhjet tjera të këtë më shumë gra udhëheqëse komunash dhe thekson që ky nuk është post i dizajnuar vetëm për burrat. Gjate punës në Qeveri dhe Komunë ajo ka krijuar një numër partneritetesh me organizata dhe vende me renome ndërkombetare ku së bashku kanë dizajnuar dhe zbatuar projekte të rëndësishme zhvillimore.

Kur flasim për hobi dhe sport Mimoza është shembulli më i mirë i një maratoniste dhe një grua që i arrin të gjitha. Zgjohet cdo mëngjes në ora 5:30h dhe fillon ditën me vrapim. Vrapi e ndihmon që të jetë më e organizuar gjatë ditës, më qëndrueshme, që të ketë fokus dhe koncentrim më të madh dhe natyrishtë në aspektin shëndetësorë thekson që ka harruar kur ka pasur ndonjë problem.

Mimoza Kusarin e frymëzojnë të rinjët e guximshëm, kreativ dhe inovativ. Gjithashtu gratë në politikë të vendeve tjera të cilat kanë tejkaluar sfida shumë të mëdha ku disave ju ka kushtuar edhe me jetë. Prej liderëve botërorë, asaj i bën përshtypje karakteri i njerëzve që mund të asociohen me periudhën e sotshme në ngritje dhe shtetëndërtim siç është babai i Turqisë Moderne Kemal Ataturk. Është një prej atyre karaktereve që të frymëzojnë në momentet e lidershipit dhe krizave. Ajo thotë që askush nuk do ta bëj punën tende për ty, atë duhet të bëjmë ne vet. E ardhmja e saj politike ndërlidhet ngushtë me sendërtimin dhe zhvillimin e shtetit te ri te Kosovës dhe integrimin, pjesëmarrjen, partneritetin dhe tregtinë e saj ne arenë ndërkombëtare dhe Euro-Atlantike.

MIMOZA KUSARI LILA – GJAKOVË

“Askush nuk do ta bëj punën tënde për ty, atë duhet ta bësh vet!”

FIONA BEQIRI

Drejtoreshë e Swiss IT-Factory, një kompani internacionale me seli në Cyrih të Zvicrës, që vepron në Prishtinë. Ka përfunduar me sukses Mastër për Web Technologies në Linnaeus University, në Suedi, ndërsa, është diplomuar si Inxhiniere e Elektros, në Universitetin e Prishtinës. Praktikatat e para i morri në Robert Bosch të Gjermanisë, kompani multi-nacionale me nam në fushën e inxhinierisë dhe elektroteknikës. Basketbolliste në ekip të femrave tash e katërmbërdhjetë vite në Pejë. Reprezentuese e Kosovës për tre vite me radhë. Znj. Beqiri sportin e ka pasionin më të madh duke mos lënë anash fotografinë, udhëtimet dhe gatimet. Porosia e saj është që duhet të jemi të vendosura në atë që deshirojmë.

Fiona Beqiri është Elektro Inxhiniere e suksesshme nga Peja, ndërsa tashmë dy vite e gjysmë Drejtoreshë Menaxhuese në degën e kompanisë Swiss IT- Factory në Prishtinë ku janë të punësuar 18 persona. Swiss IT- Factory është kompani me seli në Cyrih të Zvicrës e cila zhvillon zgjidhje softuerike gjithëpërfshirëse për kompanitë e ndërtimit, patundshmërive dhe kontraktimit gjeneral.

Për më tepër, znj. Beqiri është tash e shtatë vite oganizatore dhe zhvilluese e aplikacionit të Festivalit te Filmit të Animuar në Kosovë, të njohur si ANIBAR. Në festivalin vjetor ANIBAR marrin pjesë të rinjë ndërkombëtar dhe vendor inovativ përfshi nga vendet si: Irlanda, Anglia, Franca, Gjermania dhe shumë vende tjera, ndërsa misioni i festivalit është t'i inkurajojë vecanërisht artistët e rinjë të eksperimentojnë dhe punojnë me animacione në mënyrë që të shprehin idetë e tyre dhe pikëpamjet për botën.

Ajo ka arritur që të kryej praktiktën në njërën ndër kompanitë më të mëdha në Gjermani Robert Bosch, të cilën edhe e konsideron si projektin më të sukseshem të saj sepse e kanë mësuar dhe motivuar rezultatet të cilat i ka arritur në atë kohë. Në vitin 2011, Robert Bosch ka qenë

kompania furnizuse më e madhe në botë për pjesë automobilistike. Ajo thekson që angazhimi, puna si dhe shfrytëzimi i mundësive, sidomos duke punuar në kompani të huaja, ia kanë mësuar një kulturë të re të punës të cilën e praktikon edhe sot.

Edukimi i mirë nga Linnaeus University në Suedi ku e ka përfunduar Magjistraturen me shumë sukses si dhe, Univesiteti i Prishitines, përfshi një numër kursesh profesionale në vend dhe jashtë e kanë ndihmuar atë të ketë një përgatitje të mirë profesionale për tregun e punës.

Znj. Beqiri është gjithashtu basketbolliste suksesshme e ekipit te femrave Penza në Pejë tash e 14 vite dhe si përfaqësuese e Kosovës në Basketbollë, për tre vite me radhë. Duke qenë basketbolliste sigurisht që pasioni i saj i madh mbetet basketbolli dhe sporti. Por ajo gjatë kohës së lirë e ka pasion edhe fotografinë dhe pregaditjen e ushqimeve. Fiona udhtëton shumë pasi që edhe puna e saj është në mes të Zvicres dhe Kosovës.

Fiona konsideron që për çdo arritje njeriu duhet të sakrifikoj diçka. Ajo mundohet ti balancoj gjërat e rëndësishme, mirëpo nganjëherë koha e shpenzuar në angazhime larg familjes dhe shoqërisë mund të konsiderohet sakrificë. Ajo thekson se ndihet e kompletuar vetëm kur i menaxhon prioritetet e saj. “Është e rëndësishme me u adaptu në punë dhe familje dhe më u sfidu më ato që të përngojnë” thekson Fiona. Udhëheqja e kompanisë, menaxhimi i punëve, menaxhimi i punëtorëve, mbikqyrja e projekteve mbetet sfidë e pandalshme për Fionën por thekson që avansimi i kompanisë dhe ai professional, janë motivi i saj më i madh për të vazhduar tutje.

FIONA BEQIRI – PEJË

“Duhet të jemi të vendosura në atë që dëshirojmë të arrijmë dhe pastaj, pa marr parasysh dështimet, të përpiqemi vazhdimishtë”.

LENDITA HAXHITASIM

Lendita ka arritur të jetë pjesë e brezit të parë të sherbimit diplomatik të shtetit tonë te ri. Momentalisht Diplomate karriere në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Uashington, ajo më gjithashtu ka shërbyer edhe në kryeqendra të rëndësishme si në Bruksel ku gjendet selia e Bashkimit Europian dhe New York City ajo e Kombeve të Bashkuara. Ciklin e studimeve themelore si edhe ato master në Marrëdhënie Ndërkombëtare i ka kryer në Itali. Person që të inspiron me pasionet e saj, ajo luan piano, merret me joga dhe çiklizëm. Eksploron vende të ndryshme duke mos u ndalur së udhëtuari asnjëherë. Porosia e saj është që te mos ndaloni kurrë së ëndërruari dhe angazhuari për ato që realisht doni të arrini.

Pak persona kanë arritur që të shërbejnë për vendin e tyre në tri shërbimet diplomatike me më rëndesi atë të Washington DC, Bruksel dhe New York City. Znj. Haxhitasim është e previlegjuar në këtë drejtim por ajo ketë sukses e arriti falë punës së saj të mirë dhe përgatitjes profesionale. Diplomate karriere, ajo momentalisht punon në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Uashington. Gjeneratë që është rritur në një situatë të jashtëzakonshme politike në Kosovë ajo është e lidhur me diplomacinë dhe përfaqësimin e denjë të shtetit andaj edhe e ushtron këtë profesion me shumë pasion.

Znj. Haxhitasim gjatë punës së saj merr pjesë në forumet më të larta ndërkombëtare sic janë Këshilli i Sigurimit dhe punëtori dhe konferenca të rendësishme në Uashington. Ajo gjatë angazhimit në Ambasadën e Kosovës në Bruksel ka bashkëpunuar në baza ditore me Parlamentin Europian, Komisionin Europian dhe Shtetet Anetare të BE-së si dhe ka këshilluar e ndihuar delegacionet e shumta të Kosovës gjatë vizitave dhe punimeve atje. Lendita është angazhuar me vite të tëra për përfundimin me sukses të proceseve me rëndesi sic janë Marrëveshja për Stabilizim Asociim me BE-në dhe Procesi i Liberalizimit të Vizave.

Ajo ka investuar në përgatitjen e saj profesionale dhe ka qenë e diciplinuar kur është në pyetje edukimi. Pas përfundimit me sukses të studimeve të Shkencave Politike në Itali ajo ka magjistruar për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin e Kalbrisë në Itali i cili është pjesë e Erasmus dhe ka dhjetra bashkëpunime kërkimore me Universitet në pjesë e të ndryshme të Europës.

E lindur ne Peja ajo ka arritur të jetë model sa i perket brezit të parë të diplomacisë së re të shtetit tonë. Mbase projekti më i rëndësishëm për të është vetë fakti që ka shërbyer në kryeqendrat më të rëndësishme. Duket sikurse me e mira nga Znj. Haxhitasim ka për të ardhur në të ardhmen falë eksperiencave të rëndesishme të fituara në Burksel, NYC dhe Washington.

Lendita është ithtare e barazisë gjinore. Ajo ka pasur momente kur shumëçka nuk ka shkuar siç ka dëshiruar, por ajo që e motivon çdo ditë është dashuria që ka ndaj punës dhe dedikimi për një kauzë që e tejkalon përditshmërinë. Nuk ka ndonjë ikonë, por shembuj konkret të inspirimit për të ka qenë gjyshja ndërsa vazhdon të jetë nëna e saj me empatinë, mirësinë dhe pozitivitetin që ka si një grua e fuqishme. Ajo thekson që është e rrethuara nga kolegë dhe mikesha që e inspirojnë me energjinë dhe dinamizmin e tyre dhe kjo e inspiron tej mase.

Kur flasim për hobi është vështirë të kufizojmë Lenditën në një hobi, ajo ka shumë pasione. Është dashamire e artit, e konsumon dhe e adhuron në mënyrë mjaftë pro-aktive. Ajo luan piano, muzika klasike do të mbetet gjithmonë pasioni i parë për të. Për sportin ajo gjithnjë është në eksplorim e sipër por vazhdimisht i kthehet çiklizmit dhe jogas. I pëlqen shumë të udhëtoj, ndonjëherë i duket që është boheme e lindur dhe për momentin pasuria e vetme dhe me e madhe qe e posedon është - përvoja!

LENDITA HAXHITASIM - PEJË

"Mos ndaloni kurrë të ëndërroni, me punë, dedikim dhe mbështetje për njëra/i tjetrën/in mund ti arrini të gjitha".

MIKETE HAJDARI

Misioni i saj jetësorë është angazhimi për të ndihmuar fëmijët që kanë probleme me shkrim, lexim dhe të shprehur. Është Logopede dhe Psikologe me profesion ndërsa aktivitetin e zhvillon në tërë Kosovën. Psikologe dhe këshilluese e shumë femrave dhe familjeve vikitima të dhunës dhe me probleme familjare. E shkolluar në Prishtinë dhe Beograd dekada më parë, Znj. Hajdari, është magjistre për Terapi dhe Këshillim Familjar. Grua, nënë dhe gjyshe..., tërë jetën me stoicizëm dhe përkushtim maksimal ka arritur të ndihmoj qindra fëmijë. Ecja ne natyrë dhe vozitja mbesin pasionet e saja. Porosia e saj është që të jemi vetëvetja dhe të kemi guxim të ndërmarrim hapa konkret për të sëndërtuar një jetë dhe karierë të suksesshme.

Miketa Hajdari që 13 vite është udhëheqëse e institucionit parashkollorë "Shtëpia e Diellit". Psikologe e "Shtëpisë së Sigurtë" në Pejë e cila vazhdimisht ju jep këshilla dhe i ndihmon në procesin e rehabilitimit gratë dhe vajzat të cilat kanë probleme dhe dhunë në familje. Prej vitit 2003 ajo ka ndihmuar fëmijët në të gjitha qytetet e Kosovës që kanë problem në shkrim, lexim dhe në të shprehur. Ndërsa gjatë viteve të nëntëdhjeta Miketa Hajdari është angazhuar për të ndihmuar fëmijët boshnjakë refugjatë në Kosovë.

Profesionin e saj e ushtron me mjaftë përgjegjësi. Ka kontribuar dhe ka qenë e angazhuar në projektin psikosocial të përkrahur nga KriefsKinder Nothilfe Gjerman i cili është shpallur si projekti më i suksesshëm në përkrahje të familjeve dhe viktimave të luftës.

Znj. Hajdari është e diplomuar në Fakultetin e Logopedisë dhe Psikologjisë në Prishtinë. Më pas ka vazhduar mw studimet mastër në një ndër universitetet prestigjioze të Beogradit si Magistre në Terapi dhe Këshillim Familjar. Tërë eksperiencën profesionale dhe jetën e saj deri sot ju ka kushtuar fëmijëve.

Shkëputuni si pjesë përbërse e të qenurit nën hijen e përsonit tjetër-simbioza. Sëndërtoni egon tuaj, jeni vetvetja, keni guxim të ndërmerrni hapa konkret."

Ajo nuk i ndan vështërsitë e udhëheqjes në bazë të gjinisë dhe thekson që menaxhimi në nivel të lartë është cështje sfidues. “Ti e mer një obligim në supet e tua për gjithë ata njerëz rreth vetes, pra, është njejtë sikurse një prijës i një beteje. Çdo muaj është një betejë në vete kur duhet të arrish të sigurosh një bilanc përfundimtar pozitiv”. Kur flasim për sfidat, ajo tash po përballet me një sfidë duke përfunduar ndërtimin e një Qendre të Madhe në Pejë të dedikuar fëmijëve.

Miketa është grua, nënë dhe gjyshe e rrethuar me shumë dashuri nga familja dhe nipërit të saj të cilët i japin forcë dhe motiv që të kujdeset dhe edukoj edhe fëmijë të tjerë. Shpeshherë e privon veten nga kënaqësitë ditore, por në jetëgjatësi ajo kohën e humbur me familje e kompenzon duke realizuar dhe arritur synimet që i ka. Edhe pse nuk ka shumë kohë te lire ajo gjenë kohë për ecje nëpër natyrë dhe thotë që i pëlqen të udhëtojë. Vozitja mbetet hobi i saj i preferuar.

MIKETA HAJDARI – PEJË

MIRLINDA KUSARI PURRINI

Anëtare e lartë e Rrjetit Kosovare të Grave në Biznes, themeluese dhe udhëheqëse e Shoqatës Afariste të Gruas "SHE-ERA". Ka realizuar mbi 60 projekte të shumta që kanë fuqizuar gratë përmes arsimimit ekonomik, programeve të punësimit. Ka zhvilluar studime të rëndësishme kërkimore që e kanë mbuluar një gamë të gjerë temash përfshi Ndërmarrjet e Vogla dhe Mesme dhe te Grave Sipërmarrëse. Deri më sot mbi 14,000 femra anembanë Kosovës kanë përfituar nga shërbimet SHE-ERA-s. Udhëton shumë dhe ka një partner i cili e përkrah çdo herë. I pëlqen të gatuaj ku edhe gjenë çlodhje dhe relaks. Porosia e saj është që gratë te bashkëpunojnë dhe bashkohen. "Vetëm të bashkuara rruga drejt suksesit është e sigurtë", pohon ajo. Është dekoruar në Uashington me çmimin "World of Difference Award" nga The International Alliance for Women.

Znj. Purrini është anëtare e Aleancës Ndërkombëtare të Grave dhe Lobin e Grave të Kosovës. Eksperienca e saj profesionale përfshinë gjithashtu rolin dhe angazhimin si themeluese dhe këshilltare e lartë e rrjetit Kosovare të Grave në Biznes si dhe Presidente e Shoqatës Afariste të Gruas SHE-ERA të cilën e ka themeluar në vitin 1999, me synim për të mundësuar grave ndërtimin e sektorit ekonomik që ishte shkatërruar gjatë konfliktit në Kosovë. Me SHE-ERA ka realizuar mbi 60 projekte që kanë fuqizuar gratë përmes arsimimit ekonomik, programeve të punësimit dhe ka kryer studime të rëndësishme kërkimore që e kanë mbuluar një gamë të gjerë temash si NVM-të dhe të grave sipërmarrëse.

Gjate karrierës së saj ajo ka bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare si dhe ka pasur eksperienca profesionale për shembull me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim apo siç njihet në Kosovë si, IOM. Vizioni dhe puna e saj u përputh me idetë e partnerëve ndërkombëtar që kërkonin struktura vendore të orientuar në mbështetje te zhvillimit ekonomik, si hap drejt zhdukjes së varfërisë, rritjes së punësimit përmes ngritjes së kapaciteteve menaxhuese. Pabarazia ndërmjet

burrave dhe grave e theksuar vite më parë e shtyu që të punojë në drejtim të mbështetjes së grave, që ato të ndjehen të barabarta në shoqëri. Qëllimi i saj ishte për të rritur udhëheqjen e grave në të gjitha fushat dhe këtë beson që e ka arritë me shumë sukses.

Ajo është e lidhur me profesionin e saj dhe nëse shikojmë mbrapa deri më sot mbi 14,000 gra dhe vajza anembanë Kosovës kanë përfituar nga shërbimet e SHA-ERA të udhëhequr nga Mirlinda Kusari Purrini. Si rezultat, mes tjerash, familje që nuk kishin të ardhura tani kanë bizneset të cilat udhëhiqen nga gratë. Për angazhimin e saj dhe përkrahjen e grave është dekoruar me 2011 ne Uashington me çmimin "World of Difference Award" nga The International Alliance for Women Award.

Znj. Purrini është e lindur në Gjakovë, studimet akademike i kreu ne Prishtinë në Fakultetin e Ekonomisë dhe Financave duke vazhduar në mastër për Menaxhim Gjeneral Ndërkombëtar në Globus International ne Kosovë. Ka marrë pjesë dhe përfunduar një numër kursesh dhe punëtorishë profesionale në Kosovë dhe jashtë përfshi Trajnimin për Trajner në ngritjen e kapaciteteve për Organizata Joqeveritare në Danimarkë; Përgatitje te Biznes Planeve ne Maqedoni; Shkollën e Institutit Riinvest për Ndërmarrësi etj.

Ajo thotë se sigurohet që te balancoj jetën private me atë profesionale. Është e martuar dhe ka një partner i cili e përkrahë dhe i jep forcë dhe kurajo të zhvillohet vazhdimisht. "Kuptohemi shumë mirë ndoshta nga ajo se të dy i përkasim të njëjtit profesion". Madeleine Albright, është model i saj, ku nuk heziton të citoj thënien e saj se si "nuk duhet të heqim dorë nga gjërat që kemi punuar shumë për të arritur këtu ku jemi".

Pasion e ka kuzhinën dhe thotë që gjatë përgatitjes së ushqimit çlodhet dhe relaksohet. Udhëton shumë me punë dhe privatisht ndërsa herën e fundit morri pjesë në Konferencën "Gratë në ndërmarrje mikrofinanciare dhe Start-Up" në Taiwan ku përveç eksperiencës ajo mësoj shumë edhe për kulturën dhe zakonet në Taiwan.

MIRLINDA KUSARI PURRINI – GJAKOVË

> Udhëtimi drejt suksesit nuk do të thotë që të ecni i vetëm. Latinët thonë "Bashkimi bënë fuqinë".

SAFETE GACAFERRI

Themeluese e shoqatës “Jeta” në Deçan me qindra anëtare gra. Organizatore eskpozitash, panairesh, promovuese e traditave dhe kulturës së rajonit të Dukagjinit. Menaxhere e muzeut “Mullini” që ju mundëson femrave nga të gjitha trevat të ekspozojnë dhe shesin veshjet e punuara tradicionale. Mundësoi uljen e papunësisë në atë zonë duke përkrahur shumë femra të nisin biznes të tyre prej zeros. Të gjitha këto e bëjnë të veçantë znj. Gacaferri. Ajo e pelqën natyrën dhe të bukuren andaj gjithmonë gjatë kohës së lirë udhëton nëpër vende me gjelbërim dhe natyrë të bukur. Porosia e saj është që asnjëherë të mos i humbim shpresat për atë që dëshirojmë.

Nënë e pesë fëmijëve znj. Gacaferri vendosi që me vajzën e saj të vazhdojë studimet akademike në Univerzitetin e Prishtinës për Administrim Biznesi. Prej vitit 2005 është udhëheqëse dhe themeluese e shoqatës “Jeta” ku tash ka qindra anëtare. Përmes organizatës “Jeta” ka ndihmuar qindra gra në aftësim profesional dhe ka përkrahur dhe mundësuar startimin dhe administrimin e bizneseve të tyre personale. Momentalisht, punësimi i femrave në Kosovë është një ndër cështjet me diskriminuese ku vetëm rreth 25% të femrave janë të punësuara – ndërsa tek Femrat e Reja situata është më e keqe me vetëm 9% të tyre janë të punësuara.

Angazhimi dhe misioni i zonjës Gacaferri është me të vertetë domethënës dhe i rëndësishëm. Prej vitit 2005 deri më sot janë pothuajse 52 biznese të themeluara në rajonin e Dukagjinit nga ndihma e zonjës Gacaferri dhe stafit të saj. Ajo shprehet se “Problemi më i madh i grave në Kosovë është pjesëmarrja e ulët në punësim” gjë që e shqetëson znj. Gacaferri. Për të adresuar këtë ajo cdo herë ju mundëson femrave të reja kurse të rrobaqepësisë, të floktarisë, biznes planeve që ato të jenë në gjendje të fillojnë një biznes të tyrin për një kohë të shkurtë.

Udhëheqëse e muzeut Mullini i cili gjindet në Decan, ju mundëson grave nga e tërë Kosova dhe rajoni që të ekspozojnë dhe shesin veshjen dhe punimet tradicionale të trevave të tyre. Më shumë se 10 vite e ka menaxhuar Kullën e Mazrekajve në Deçan, Kullë që ka pranuar mijëra vizitorë vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët kanë pasur rastin të shërbehen me ushqim tradicional, kulturë dhe traditë të asaj anë. Për më tepër, ka organizuar shumë panaire për turizëm me veshje dhe ushqim tradicional jo vetëm në Kosovë por edhe në Mal te Zi dhe Shqipëri.

Znj. Gacaferri është kryefamiljare, përkujdeset për familjen, dhe vazhdimisht investon në avancimin profesional të saj. Ajo gjithmonë merr pjesë nëpër konferenca dhe trajnime sepse mëson diqka te re e cila i ndihmonë në udhëheqjen dhe menaxhimin sa më të sukseshëm të organizatës. Është vështirë të depërtosh në një vend të vogël si Deçani ku paragjykimet janë edhe sot prezente por përkushtimi i madh e ka motivuar për punë. Ajo gjithmonë motivohet prej grave pjesëtare të shoqatës të cilat janë shpresa dhe guximi për të vazhduar tutje. Safetja e pëlqen natyrën, i pëlqejnë bjeshkët pjesë të bukra të Kosovës dhe jashtë saj. Hobi i saj më i madh është të udhëtojë nëpër vende me natyrë të bukër.

SAFETE GACAFERRI – DEÇAN

“

Keni durim, tentoni dhe asnjëherë mos i humbisni shpresat!

SYZANE BAJA

Përfaqësuese e Solidar Suisse në Kosovë organizatë ndërkombëtare me seli në Pejë dhe Prishtinë. E angazhuar në OSBE dhe Shoqëri Civile për shumë vite. Mastër në Menaxhment, vajzë me vullnet të madh për punë, energjike dhe e përgjëgjshme ndaj shoqërisë ku jeton. Cdo përpjekje e saj është e lidhur ngushtë me ndërtimin e një mjedisi më të mirë për vendin. Vajzë sportive e cila mirret me aerobic. Thotë që aktivitet sportive janë të domosdoshme dhe të mirëseardhura duke pasur nivelin e presionit, ngarkesës dhe stresit që shkaktohen nga puna dhe obligimet tjera. Porosia e saj është që të duam, të punojmë me zell dhe përkushtim të madh.

Që nga viti 2010 përfaqëson Solidar Suisse në Kosovë, organizatë ndërkombëtare me seli në Pejë dhe Prishtinë e cila bazohet në dy parime thelbësore: sigurimin e të ardhurave përmes punësimit dhe kushteve dinjitoze të punës. Mundohet për një komunitet demokratik në të cilin qytetarët dhe të drejtat e punëtoreve janë të siguruara. Znj. Baja ka përfundur edukimin bachelor në informatikë të aplikuar në biznes për të vazhduar me mastër në drejtimin Menaxhment. Ajo që nga viti 2010 përfaqëson Solidar Suisse. Përvoja e saj profesionale fillimisht ka filluar në OSBE me organizimin e zgjedhjeve në Kosovë për të vazhduar në sektorin e Shoqërisë Civile duke u angazhuar në zhvillimin e sektorit të turizmit në Regjionin e Pejës.

Arritjet kryesisht i lidhë ngusht me përkushtimin, vullnetin për të bërë dicka më mirë dhe të nevojshme, me shumë zotësim në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive si dhe shumë punë në aspektin edukativ dhe atë profesional. Syzana thekson se e do shumë punën dhe bën përpjekje që ta kryen me përkushtimin të madh . Gëzon vullnet dhe energji të konsiderueshme si dhe zotësohet në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive që i janë besuar. Puna i shërben si bazë dhe rrugëtim për

të bërë dicka të nevojshme dhe të mirë për vendin. Çdo përpjekje është e lidhur ngushtë me ndërtimin e një mjedisi më të mirë si dhe me fuqizimin e shoqërisë që do të qojë drejtë një të ardhme me të mirë dhe me të ndritshme për të gjithë.

Kur flasim për sfidat dhe sakrificat Syzana thekson që duke qenë femiu më i madh dhe vajzë ,sakrificë i është bërë në kohën më të cmuar . Në shumë momente dhe ngjarje te vecanta në familja nuk ishte prezente fizikisht. Ndërsa jo aq shumë kohë ka kaluar me shoqëri. Ndonëse gjithmon e kanë mirëkuptuar , respektuar vendimet dhe përkrahur ndaj edhe ndan momente dhe kujtime te bukura . Konsideron që ato momente e kanë shërbyer si katalizatore të motivimit dhe inspirimit. Kur dëshiron, duash dicka gjithmonë gjenë mënyra dhe mjete si të ia dalësh mbanë thotë Syzana.

Syzana ka shumë modele por nuk dëshiron të vecojë ndonjë individ. Ata i takon cdo ditë. Thekson që e inspirojnë vajzat e reja aktive, të rinjët. Gjithë këta i shërbejnë si model për të mësuar dhe kuptuar shumë. I pëlqejnë aktivitet fizike dhe mirret rregullisht me ushtrime të aerobikut. Thotë që aktivitet sportive janë të domosdoshme dhe të mirëseardhura duke pasur nivelin e presionit, ngarkesës dhe stresit që shkaktohen nga puna dhe obligimet tjera.

SYZANE BAJA – PEJË

“Jeni vëtvetja dhe besoni në veten e tuaj. Merrni mësime dhe praktika të mira nga të tjerët. Jeni të hapur dhe më të guximshëm. Të punojnë atë që duan me të vertetë të punojnë me zell dhe më perkushtimin më të madh.”

VEPRORE KUMNOVA

Avokon dhe lobon për adresimin e të drejtave të grave të dhunuara gjatë luftës. Kordinatore dhe udhëheqëse e Medica Kosova organizatë që mirret dhe përkrahë femrat e traumatizuara nga lufta. Menaxhere e zonja që deri sot ka zhvilluar dhe zbatuar me sukses rreth 40 projekte që kishin për qëllim përkrahjen psikosociale të femrave. Qytetare Nderi e San Diegos, California - SHBA, për ndërtimin e paqës dhe përmisimin e situatës në Kosovë. Organizatore e shumë ekspozitave ndërkombëtare për sensibilizim e shoqërisë kundër dhunës. Lidere bashkohore më synime afatëgjata, Znj Kumnova është adhuruese e leximit dhe pëlqen autorët si Brunilda Zllami dhe rus Fiodor Dostojevski për shkak të temave psikologjike dhe filozofike që trajtojnë. Porosia e saj është që njerzit të jenë të vendosura dhe të jenë të gatshëm të sfidohen për të arritut më shumë. Frymëzohet nga rikthimi i buzëqeshjes te gratë.

Në vitin 1999 ka filluar të punoj në Medica Kosova si kordonatore lokale për të marrë me pastaj udhëheqjen ekzekutive të organizatës në vitin 2004, me seli në Gjakovë. Medica Kosova përkrah femrat e traumatizuara nga lufta me theks të posaqëm ato që i kanë mbijetuar dhunës seksualë gjatë luftës. Znj Kumnova mes tjerash ka marrë pjesë edhe në konferencën për paqe në San Diego ku është diskutuar për cështjen e të zhdukurve dhe grave të dhunuara gjatë luftës. Pas rekomandimeve për përmisimin e situatës dhe ndërtimin e paqës është vlersuar me titullin "Qytetare Nderi e San Diegos" ne vitin 2004.

Deri sot së bashku me stafin ka menaxhuar rreth 40 projekte që kishin për qëllim përkrahjen psikosociale të femrave, përkujdesjen gjinekologjike, ndihmën juridike dhe përmisimin e kushteve jetësore përmes regjenerimit të të ardhurave. Znj. Kumnova është aktive në fushën e avokimit dhe lobimit për adresimin e të drejtave të grave të mbijetuara nga dhunimet gjatë luftës. Është pjesë e shumë grupeve punuese që kontribuan në draftimin e Planit Nacional te Veprimit për Implementimin e Rezolutës së OKB-së 1325, pregaditjen e legjislacionit për integrimin e femrave të dhunuara në Ligjin për Vlerat

e Luftës; dhe së fundi për Planin e Veprimit për qasjen e tyre ne drejtësi dhe dokumentimin e dhunimeve si krim lufte.

Veprore Kumnova ka zhvilluar shumë projekte për sensibilizimin e shoqërisë kundër dhunës përmes artit. Një ndër projektet kreative përfshinë realizimin e mbi 60 pikturave nga gratë e moshuara per senzibilizim të publikut dhe vendimmarrëseve. Ka realizuar ekspozitë ndërkombëtare në Londër gjatë Samitit Global për Luftimin e Dhunës Seksuale në zonat e konfliktit me 2014 të organizuar nga ish Ministri i Jashtëm i Mbretërisë së Bashkuar, z. William Hague, ku mori pjesë edhe Përfaqësuesja e Vecantë e Kombeve të Bashkuara artistja e famshme Angelina Jolie. Gjithashtu në Suedi, me ndihmën e organizatës Suedeze Kvinna till Kvinna, është ekspozuar një numër i këtyre pikturave në Stokholm dhe qytetin Univerzitar Umea ne Suedi.

Znj. Kumnova ka qenë pjesëmarrëse e programit të famshëm Hope Fellowship që është realizuar dhe ka kryer punë praktike në Washington D.C. Ky program e ka transformuar prej një lidere klasike më qëllime dhe veprime simultane në një lidere bashkohore me synime afatëgjata të arritjes së ndryshimeve përmes mendimit strategjik, mësimit të vazhdueshëm dhe mbi të gjitha duke qenë shembull i mirë për të tjerët. Konsideron se çelësi i suksesit është përceptimi i nevojës për të mësuar në harmoni me kërkesat e kohës. E motivon familja, nipërit e saj. E frymëzon rikthimi i buzëqeshjes te gratë.

Ajo gjatë kohës së lirë shikon filma dhe lexon. I pëlqejnë librat sidomos të dy autorë. Brunilda Zllami për shkak të mënyrës së trajtimit të intrigave dhe ambicjeve të personazheve të veta dhe shkrimtari rus Fiodor Dostojevski për shkak të temave psikologjike dhe filozofike që ai trajton ne veprat e tij.

VEPRORE KUMNOVA – GJAKOVË

> Dituria është arma me fortë kundër çdo lloj diskriminimi posaqërisht atij gjinorë; ndërsa çelësi i suksesit për cdo femër që synon të zhvillohet është vendoshmëria dhe guximi për të sfiduar mentalitetin dhe anti-vlerat.

XHENET SYKA

Prezentuese e sukseshme në mediat lokale qysh nga viti 1999 (Radio dhe TV Dukagjin). Këshilltare në Asamblenë Komunale në Pejë për një dekadë. Ligjëruese në Kolegjin Dukagjini. Xhenete Syka ka magjistruar në Bled të Sllovenisë për Administrim Biznesi ndërsa aktulishtë është duke kryer tezën e doktoraturës në drejtimin e sociologjisë dhe antopologjisë për dhunën në baza gjinore në Univerzitetin European të Tiranës. Atraktive, elegante kemi mundësi të shohim cdo mëngjes në programin televiziv te mëngjesit. Nanë e një djali të vogël e cila ofron shumë dashuri edhe përkushtim edhe pos angazhimit të madh që ka. Ajo lexon shumë, ka pasion udhëtimin, i pëlqejnë metropolet, kulturat e reja në veçanti diversitetin kulturor. E pëlqen renesancën, ringjalljen e Firencës. Porosia e saj është që të bashkohemi dhe të mbështesim njëra tjetrën.

Prezente në Media qysh në vitin 1999 së pari në Radio Dukagjin duke ndihmuar për skenën programore e aktualisht Redaktore në TV Dukagjini, televizion dhe radio më shumë dëgjueshmëri e shikueshmëri në rajonin e dukagjinit por edhe tërë Kosovën. Atraktive dhe elegante znj. Syka na drejtohet cdo mëngjes me programin e saj. E diplomuar në Ekonomi në Universitetin e Prishtinës, duke pasur parasysh që punon në një kompani private i nevojiteshin informacione të reja për menaxhimin e tregut dhe menaxhimin e resurseve andaj vendosi të vazhdojë me mastër për Administrim Biznesi në Bled të Sllovenisë. Aktualisht është duke kryer tezën e doktoraturës në drejtimin e sociologjisë dhe antopologjisë për dhunën në baza gjinore Universitetin European të Tiranës.

Pothuajse një dekadë është këshilltare komunale në Komunën e Pejës. Dy mandatet e para kanë qenë mazhorancë në Kuvendin Komunal të Pejës ku me ç'rast, roli dhe përgjegjësia ka qenë më e madhe duke insistuar gjithmonë në projekte dhe implementimin e tyre. Xheneta është zotuar qysh në anëtarsimin e saj që segmenti

kryesor do të jetë barazia gjinore, ngritja e zërit të gruas, respektimi i saj në shoqëri, instuticione dhe familje.

Xheneta është edhe ligjëruese në Kolegjin Dukagjini në Pejë, kolegj ky i cili funksionon në kuadër të kompanisë Dukagjini në Pejë. Kur ajo filloj në vitin 1999 thotë që rrugëtimi mediatik nuk ka qenë i lehtë. Ka qenë një rrugëtim i nisur prej ditës një, i mbështetur na disa asosacione amerikane të cilët ndihmonin në periudha të shkurta por prapë sfida dhe barra kryesore ishte mbi ta. Ndërsa thotë që në përfshirje në politikë dhe Kolegjin Dukagjini ka qenë më e lehtë përshkak të infrastrukturës së ndërtuar. Ajo thekson se kur e zbulon punën që e do me të vërtetë, atëherë edhe nuk lodhesh.

Znj. Syka thekson që me krijimin e familjes dhe ardhjes në jetë të djalit të saj ka filluar të ketë konsideratë më të madhe për familjen sepse kryesishtë sfidatat në kuptimin privat, emocional janë të mëdha. Duke qenë person publik në dhënien e informacioneve, në vendimmarrje dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve nuk i shkojnë në balancë një vikendi privat. Por mundohet në çdo moment të anoj drejtë bilancit në mes familjes dhe jetës profesionale.

Frymëzohet dha ka model Mbretëreshën e Jordanit Rania Al Abullah pikërisht për arsyen dhe motivin se sa shumë është e përkushtuar për edukimin e femrave, pozitivitetin shpirtëror, stilin e një grua të vërtet edhe pse rrjedh prej një familje monarke arrin të jetë lidere bashkohore. Ajo gjatë kohës së lirë lexon shumë, ka pasion udhëtimin, i pëlqejnë metropolet, kulturat e reja në veçanti diversitetin kulturor. E pëlqen renesancën, i pëlqen ringjallja e Firences.

XHENETE SYKA – PEJË

> Femra është qendra e botës. Kur femrat e mbështesin njëra tjetrën gjëra të mrekullueshme mund të ndodhin".

AGNETA BYTYQI
Autore

Ky publikim u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjensisë së Shtetetëve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID. Përmbajtja është përgjegjësi e organizatës Syri I Vizionit dhe nuk pasqyron deomos pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shtetëve të Bashkuara. Broshura elaboron portretet e grave që në karieren e tyre kanë kontribouar në fusha të ndryshme për interes të publikut.

Qëllimi kryesor është që të identifikohen dhe ilustrohen shembuj të suksesit në mënyrë që të frymëzojmë gra tjera si dhe të ju shprehim mirënjohje shumë grave në rajonin e dukagjinit për kontributin e tyre të dhënë në baza ditore për familjen dhe shoqërinë.

Ky publikim fokusohet kryesishtë në persona që zhvillojnë profesionin e tyre në tri fusha: biznes/sektor privat, qeverisje dhe shoqëri civile. Gjatë selektimit, mes tjerash, janë përdorur kritere gjeografike andaj kjo përzgjedhje nuk është gjithëpërfshirëse dhe sigurisht që ka shumë gra tjera të suksesshme të cila nuk janë përfshirë kësaj radhe dhe për të cilat kemi shumë respekte.

Edhe pse vitëve të fundit kemi përparim të qëndrueshëm në përfaqësimin e gruas nëpër institucione, biznese dhe vecanërisht shoqëri civile, mbetet shumë për të bërë që bilanci në mes burrave dhe grave të jetë ashtu sic duhet të jetë 50-50% - sidomos kur është fjala për pozitat udhëheqëse nëpër institucionet publike.

Mbase fakti që pjesëmarrja e grave në tregun e punës është vetëm 18.1% ndërsa punësimi i tyre vetëm 11% tregon më së miri që mbetë shumë punë për të bërë që situata e grave të përmirsohet në Kosovë. Pavarsia ekonomike dhe financiare e gruas mbetë boshti i problematikës dhe të drejtave të tyre në shoqëri dhe familje - andaj ne duhet të punojmë me shumë si shoqëri për pjesëmarrje dhe përfaqësim me serioz të gruas.

Ne duhet të luftojmë dhe përdorim casje pozitive për të marrur atë që na takon, përfshi pozitat e larta në institucione dhe vendet e punës. Fjala nuk është për dhurata apo vendosjes së kuotave artificale edhe pse ato kanë dhënë rezultate të mira përshembull në përfaqesimin në kuvende qendrore dhe lokale.

Dëshiroj në fund t'i falenderoj kolegët e Syrit te Vizionit dhe gjithë ata që na ndihmuan që të identifikojmë dhe paraqesim storiet e suksesit të grave nga Dukagjini në mënyrë që këto të shërbejnë si frymëzim dhe burim i forcës pozitive që pozitën e gruas të përmirsojmë gjatë viteve të ardhshme progresivisht.

USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Syri i Vizionit

atrc
Advocacy Training & Resource Center